



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE

Durrës më ____ . ____ . 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: ‘‘BLERJE REAGENTE, PAJISJE LABORATORI DHE
IMPIANTI’’**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

REAGENTË KIMIKË 33696300-8

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 ‘‘Për prokurimin publik’’, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, të certifikuara nga tatimet për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit. Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- a. Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të cilësisë (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- b. Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, dhe nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a,) dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Si dhe bazuar në nenin 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me

anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Vendosja e certifikatës së kërkuar më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

Vendosja e Iso 14001 e cila është standardi ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të mjedisit dhe ISO 9001 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave dhe siguron qëndrueshmërinë e mallit që furnizohet, pra ky standard mundëson menaxhimin e cilësisë dhe vlerësimin e konformitetit si edhe menaxhimin e mjedisit, duke siguruar kështu që produktet të jenë të sigurta, të besueshme dhe të cilësisë së mirë.

Pikërisht paraqitja e këtyre ISO tregon se, OE zbatojnë sistemet e manaxhimit në përputhje me këto standarde dhe rrit performancën dhe besueshmërinë për cilësinë dhe garancinë e mallrave që do të furnizohen nga operatori ekonomik fitues. ISO duhet të jenë në emër të shoqërive dhe në objektet e këtyre certifikatave duhet të jetë përfshirë objekti i prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqes katalogët origjinale të markuar për artikujt e ofertuar. Katalogjet /Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e mallrave objekt prokurimi dhe të jenë të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që me paraqitjen e katalogut të bëhet i mundur një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara, për të përmbushur kontratën

Autoriteti kontraktor synon verifikim e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë ofertues me ato të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit.

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë...”

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi /MAH/ ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregëtojë mallrat objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave dhe përfshirë afatin e zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit 73 dhe nenit 77, pika 2 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku shprehimisht thuhet se: “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim”.

Autorizimi nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara është një dokument i rëndësishëm i cili tregon aftësitë e operatorit ekonomik ofertues si dhe është një tregues cilësor i mallit që do të ofrohet. Në gjykim të autoritetit kontraktor, ky kriter është jo diskriminues, në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike. Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik ofertues mbi përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të punësuar me kohë të plotë si më poshtë:

1. 1 (nje) kimist,

me experience në analizat e ujrave të pijshëm dhe atyre të ndotur.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Cv,
- Diplomën përkatëse dhe
- Kontratë punësimi të vlefshme.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 gërma b) dhe c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë specialiste me njohuri të nevojshme për të furnizuar produktet e nevojshme dhe për të trajnuar përdoruesit për të garantuar matje të sakta nëpërmjet sistemit të kontrollit të cilësive të pajisjeve matëse me kitet që do furnizohen.

Specialisti i mësipërm duhet të kryejnë trajnimet e stafit të laboratoreve për metodat e kontrollit të cilësive të analizave të ujit të pijshëm dhe atyre të ndotur

Kriteri mbi dokumentacionin e stafit quhet i permbushr me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, ne rast kerkohet sqarim nga AK ose ne rast se shpallet fitues operatori ekonomik duhet te paraqesi kopjen origjinale ose te noterizuar te dokumentave të kerkuara me siper prane Autoritetit Kontraktor.

Kriteri mbi dokumentacionin e stafit i cili perfshihet ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, referuar nenit 26, pika 6, te VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ‘Perpra publikimit te njoftimit te fituesit dhe dhe nisjes se afateve te ankimit, operatori ekonomi i kualifikuar i pari duhet te paraqesi dokumentacionin provues te parashtruar ne pikat ‘a’, ‘b’, ‘d’, ‘dh’, ‘e’, ‘h’, ‘i’, ‘j’ te pikes 2 te ketij neni si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten origjinale ose kopje të njesuar me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Operatorët Ekonomike qe do te marrin pjese ne kete procedure tenderi, te jene sa me serioze per te garantuar nje proces te rregullt pa deskriminuar apo favorizuar ndonjerin prej tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e punëve qe lidhen me objektin e prokurimit per te garantuar analiza te ujit me saktesi te larte me perdorimin e kiteve dhe reagenteve qe do furnizohen.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- 2.4.1. Operatori Ekonomik ka detyrimin të kryejë të kryejë kontrollin e cilësisë së analizave me solucione etalone të rekomanduara.
- 2.4.2. Operatori Ekonomik ka detyrimin të kryejë testimet dhe kalibrimet e paisjeve objekt te prokurimit

Për pikat e mesiperme operatori ekonomik duhet të paraqesi vetëdeklarim.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar nenin të 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë AK nepermjet nje vetedeklarimi ne lidhje me kontrollin dhe kalibrimet e gjithë pajisjeve qe perdoren ne procedurat e analizave te ujit te pijshem dhe ujit te ndotur .

Keto kritere duhet te garantojne qe kitet te japin rezultate te sakta te analizave duke perdorur pajisjet ekzistuese laboratorike. Kriteri është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.

2.4.3. Kitet te plotesojne standartin per analizat e ujrave te ndotur te impianteve te trajtimit.

Per pikën e mesiperme operatori ekonomik duhet të paraqesi vetedeklarim.

Argumentim: Kitet duhet te jene konform parametrave te percaktuar ne ligjin 9115, dt 24.07.2003 “ Per trajtimin mjedisor te ujrave te ndotur”, i ligjit 8102 “ Per largimin dhe perpunimin e ujrave te ndotur” i amenduar me ligjet Nr 9352, Nr 9584 dhe Nr 9915 por edhe i VKM 177, dt 31.03.2005 “ Normat e lejuara lidhur me ceshtjet e shkarkimit te ujrave dhe kriteret zonale te organeve marrese”.

Kërkesa e mësipërme eshte bazuar përcaktuar ne nenin 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Eshte menduar se ky eshte nje kriter i domosdoshem per natyren dhe vleren e kontrates si dhe ne propocion me to, me qellim garantimin e realizimit me sukses dhe me cilesi sipas standarteve kombetare.

2.4.4. Kitet të furnizohen me manualet e përdorimit në anglish dhe Shqip

Argumentim: Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne nenin 24 te VKM 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ne te cilen percaktohet se ‘Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.’

Në rast se manualet e perdorimit nga prodhuesi vijne në gjuhen angleze ato duhet patjeter të përkthehen në gjuhen shqipe.

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër transportin e artikujve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor dhe afatet e lëvrimit

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose

originë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Nr.	Emërtimi i artikullit	Specifikimet teknike	Njësia	Sasia
1	Multiparameter portativ	Për matjen e pH, temperaturë, tensionit REDOX, përcueshmërisë, TDS, SAL dhe oksigjenit të tretur (matje optike).	Copë	1
2	Perzieres magnetik	Me ngrohës me temperaturë maksimale 500°C, kapaciteti 10 litra (për llumin dhe ujë)	Copë	1
3	Kabinet termostati	Për përzierje të vazhdueshëm për përcaktimin e BOD5	Copë	1
4	Sistemi Induktiv Nxites	OxiTop IS 6	Copë	1
5	Shishe dhe koka shishesh	OxiTop për BOD	Copë	6
6	Mini pompë laboratorike	Për sistemin e filtrimit të TSS	Copë	1
7	Erlenmeyer vakumi 1000 ml	I montueshëm tek mini pompa laboratorike, me gotë 300 ml dhe kapëse	Copë	1
8	Test Amoniaku niveli i ulët	0.010-2.000 mg/l NH ₄ -N, 0.01 – 2.58 NH ₄	Kuti 25 kyveta	25
9	Test Amoniaku niveli i lartë	4.0-80.0 mg/l NH ₄ -N, 5.2 – 103.0 mg/l NH ₄	Kuti 25 kyveta	2
10	Test COD niveli i ulët C3/25	10-150 mg/l COD	Kuti 25 kyveta	2

11	Test COD niveli i lartë C4/25	25 -1500 mg/l COD	Kuti 25 kyveta	25
12	Test Nitrate N2/25	0.5-18.0 mg/l NO ₃ -N, 2.2-79.7 mg/l NO ₃	Kuti 25 kyveta	14
13	Test Nitrite N5/25	0.010-0.700 mg/l NO ₂ -N, 0.03-2.30 mg/l NO ₂	Kuti 25 kyveta	17
14	Test Azoti niveli i ulët	0.5-15.0 mg/l N	Kuti 25 kyveta	2
15	Test Azoti niveli i lartë	10-150 mg/l N	Kuti 25 kyveta	2
16	Test Fosfori niveli i ulët P6/26	0.05-5.00 mg/l, 0.2-15.3 PO ₄ , 0.11-11.46 mg/l P ₂ O ₅	Kuti 25 kyveta	26
17	Test Fosfori niveli i lartë P7/25	0.5-25.0 mg/l P, 1.5-76.7 mg/l PO ₄ , 1.1-57.3 mg/l P ₂ O ₅	Kuti 25 kyveta	2
18	Test Ortofosfate niveli i lartë P7/25	0.5-25.0 mg/l PO ₄ -P, 1.5-76.7 mg/l PO ₄ , 1.1-57.3 P ₂ O ₅	Kuti 25 kyveta	2
19	Frenues i nitrifikimit	shishe 50 ml	Shishe	15
20	Bateri për kokat e shisheve të BOD	CR 2450, 3V LITHIUM	Copë	12
21	Kuveta kuarci, 10 mm	Kuveta standarte të spektrofotometrit, volumi 3.5 ml Permasat: 12.5 mm x 12.5 mm x 45mm	Copë	6
22	Doreza 1 perdorimshe	Sterile pa puder, kuti me 100 copë, masa 2xl	Kuti	20
23	Alkol etilik 96 %	I denatruar, dezinfektant për përdorim të jashtëm, bidon 1 litër	Bidon	20
24	Peleta hidroksid natriumi	Për përcaktimin e BOD me Ox top, kuti 1 kg	Kuti	1

25	Filtra (mikrofibra qelqi) për TSS	Ø 47 mm mikrofibra qelqi tip MGC, kuti 100 copë	Kuti	6
26	Filtra (mikrofibra qelqi) për TSS	Ø 90 mm mikrofibra qelqi, kuti 200 copë	Kuti	1
27	Pajisje për matjen e llumit	Plastike, e tejdukshme, e ndarë në 3 pjesë, H= 4.5 metra, d= 32 mm	Cope	2
28	Aparat per matjen e Klorit te lire	<p>Për matjen e klorit te lire.</p> <p>(Aparati duhet të jetë i përshtatshem për reagentet e PF-3 ose ekuivalent)</p> <p>Dedektori: Fotodiode silikoni.</p> <p>Lloji i kyvetes 1'' e rrumbullaket 16mm ,rrumbullaket me adaptor</p> <p>Vlerësimi i papërshtatshëm nga uji : IP 67. Kushtet e funksionimit: 10 - 40 °C maksimumi.</p> <p>Lagështia relative max 90%</p> <p>Mënyra e funksionimit: Transmetimi (%), Absorbimi dhe Përqendrimi</p> <p>Sistemi optik: Transmetim 0 / 180 °</p> <p>Saktësia fotometrike: ± 0,03 Abs Lineariteti fotometrik: ± 0,002 Abs (0 - 1 Abs)</p> <p>Gama matjes fotometrike: 0-2 Abs</p> <p>Riprodhueshmëria: ± 0,005 Abs (0 - 1 A)</p> <p>Burimi i drites: Diodë që lëshon dritë (LED) Gjerësia e brezit spektral 15nm</p> <p>Drita e humbur:< 1.0 % at 400 nm</p> <p>Temperature range: 0 - 50 °C</p>	Cope	1

		<p>Saktësia e gjatësisë së vales: ± 1 nm</p> <p>Fushe e gjatësisë së vales: 420, 520, 560, 610 nm</p> <p>Zgjedhja e gjatësisë së vales: Ne mënyrë automatike</p>		
29	Aparat për matjen e TDS & pH për ujë të pijshëm	<p>Aparaturë e certifikuar CE</p> <p>Eksport të të dhënave: me lidhje USB me kompiuter ose pajisje USB</p> <p>Ruajtja e të dhënave: 10,000 të dhëna</p> <p>Dimensionet (L x G x G): 63 mm x 97 mm x 220 mm</p> <p>Ekrani: Deri në 3 parametra në të njëjtën kohë</p> <p>Lloji i ekranit: 536x336 Mono-TFT</p> <p>Klasifikimi për depertushmerinë e ujit: IP67</p> <p>Lageshtira e ambientit: 90%</p> <p>Kushtet e punës: 0 - 60 °C</p> <p>Parameterat: pH, konduktivitetin</p> <p>Fusha e matjes e pH : 0 - 14 pH</p> <p>Resolucioni i pH që zgjidhet: 0.001/0.01/0.1 pH</p> <p>Fushe e matjeje e konduktivitetit: 0.00 mg/L - 50.0 g/L NaCl</p> <p>Me kompensim automatik të temperaturës për pH</p>		1

30	Aparat per matjen e turbullshmerise per ujin e pijshem	<p>Saktesia: $\pm 2\%$ e leximit dhe drites se humbur. Aparature e certifikuar CE Kuveta: 25 mm x 60 mm e rrumbullaket</p> <p>Ruan 500 rekorde</p> <p>Dimensionet (L x Gj x Gj): 77 mm x 107 mm x 229 mm</p> <p>Madhesia e ekranit: 240 x 160 pixels</p> <p>Lloji i ekranit: Graphic LCD</p> <p>Vlersimi I pershkrueshmerise nga uji: IP67</p> <p>Interface: Optional USB</p> <p>Burimi i drites: Llampe me filament Tungsteni</p> <p>Lageshtira maksimale e punes: 90 %</p> <p>Measuring range: 0 - 1000</p> <p>Njesia e matjes: NTU</p> <p>Temperatura e punimit: 0 - 50 °C</p> <p>Perseritshmeria: $\pm 1\%$ e leximit ose 0.01 NTU , cilado qofte me e larte</p> <p>Koha e reagimit: 6 s ne programimin normal te punes</p> <p>Vellimi i mostres: 15 ml</p>		1
31	Teste per Koliforme Totale	Metoda e filtrimit ne membrane nutri-disk 0.45um 14053-47-N ose ekuivalent	Copë	1000

32	Test Nitrate	0.20 - 20.0 mg/l NO ₃ -N, 0.9 – 88.5 mg/l NO ₃ -	Kuti 250 teste	6
33	Test Nitrite	0.002 - 1.00 mg/l NO ₂ -N, 0.007 – 3.28 mg/l NO ₂ -	Kuti 250 teste	4
34	Test Amoniaku	0.010 - 3.00 mg/l NH ₄ -N	Kuti 250 teste	6
35	Filtra Mikrobiologjik 47 mm per e-coli	Enterococcu, total coliform 0.45um, sterile me kuadrate	Copë	3000
36	Test Klor i lire , test per Fotometer	Reagent pluhur per percaktimin e Klorit te lire ne ujin e pijshem PF-3 ose ekuivalent	Teste	5000
37	Teste per e-Coli	Metoda e filtrimit ne membrane nutridisk 0.45um 14068-47-N ose ekuivalent	Copë	1000
38	Teste per Enterococcu faecal	Metoda e filtrimit ne membrane nutridisk 0.45um 14051-47-N ose ekuivalent	Copë	1000
39	Kontenitore sterile plastike	1 përdorimësh, 500ml për mostra baktireologjike	Copë	1000
40	Bateri per paisjen PF3	1,5 V	Copë	60
41	Kontenitore sterile plastike	1 përdorimësh, 100ml për mostra baktireologjike	Copë	200
42	Pomp e dozimit dhe seti i injektimit te klorit	Presioni maksima i moskthimit 4 bar Vellimi maksimal i injektimit 49 l/ore Numri maksimal impulseve 200/min Vellimi i nje impulsi 4.08 ml Ekran me ndricim 3” ; pamje 3-LED per funksionimin,mesazhe	Cope	1

		<p>paralajmeruese si dhe gabimet dhe qe shihet nga te tre anet</p> <p>Ne programimin manual pulsimit mund te vendosen nga 1 impuls/h deri ne 12.000 impulse/h</p> <p>Gjatesia e impulsit mund te vendoset elektronikisht nga 0-100%</p> <p>Impulset mund te gradohen ne menyra te ndyshme duke rritur dhe zvogeluar kohen e tyre si dhe ne menyre rritese dhe zvogelues.</p> <p>Faktori per kontrollin e kontaktit nga jashte 99:1-1:99 ; Gradim ne AUT ne shkalle me te vogel se 1 ml</p> <p>Mundesit lidhje me 2 celesa niveli</p> <p>3 porta shtese per hyrje/dalje dixhitale</p>		
--	--	--	--	--

Operatori Ekonomik gjithashtu duhet :

1. Të kryeje kontrollin e cilësisë së analizave me solucione etalone të rekomanduara sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor
2. Të kryeje testimet dhe kalibrimet e paisjeve objekt të prokurimit sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

Afati i lëvrimit të materialeve objekt prokurimi të jetë jo me vonë se 40 (dyzet) ditë nga nënshkrimi i kontrates me operatorin ekonomik të shpallur fitues .